ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 108A të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Për: **KOMUNA SUHAREKË**

Për Aktivitetin e Prokurimit: **624-25-2455-1-2-1**

Sa i përket tenderit për **Blerja dhe paisja me aparaturë të nevojshme për QKMF Rexhep Kuçi Suharekë**

ANKESË

1. Identifikimi i OPERATORIT EKONOMIK

"Pro Medical"
(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Kadri Zeka
(Adresa)
Ferizaj *70000*
(Vendi) *(Kodi postar)*
049-631-245
(Numri Telefonit) *(Numri i Faks-it)*

Adnan Bala
(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)
promedical.fr@gmail.com
(Adresa elektronike)

18.06.2025
(Data e parashtrimit të kërkesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i kërkesës mund ta parashtroj kërkesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse kërkesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

_____

(Emri i avokatit)

_____

(Adresa e plotë)

_____ _____

(Numri i Telefonit) *(Numri i faks-it)*

_____

(Adresa elektronike)

_____ _____

(Data e parashtrimit të kërkesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës","Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Njoftimi per kontrate: 13.05.2025 Hapja e ofertave 14.05.2025 Letrat standarde 30.05.2025 pra Vendimi AK

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ **Jo** ☐

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po [X] **Jo** ☐

6. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Dispozitat e shkelura te LPP-se:

Neni 1 – Qellimi

Neni 6- Ekonomiciteti dhe Efikasiteti

Neni 7 – Barazia ne trajtim / jo diskriminimi

Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve

7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të kërkesës suaj për rishqyrtim.

Ne si palë e interesuar – në përputhje me kuptimin e pikës 1.26 të nenit 4 ne paraqesim këtë Kërkesë për Rishqyrtim dhe duke u bazuar ne LPP dhe Rregullores Nr. 001 2022 i plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren Nr. 002 2024 Neni 60.

Neni 1- Qëllimi -E kundershtojme vendimin e Autoritetit Kontraktues te dates 30.05.2025 dhe Vendim për Refuzim të Kërkesës për Rishqyrtim të datës 09.06.2025 ngase i njejti eshte ne kundershti me nenin 1 te Ligjit per Prokurim Publik dhe paragrafin nuk ka marre ne konsiderate detyrimin.
AK në këtë rastin tonë ka shkelur Nenin 1 paragrafin 2 të LPP citim "***Ky ligj gjithashtu ka për qëllim të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe, të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji***"

Neni 6 – Ekonomiciteti dhe Efikasiteti-Autoriteti Kontraktues nuk ka respektuar paragrafin 1 të Nenit 6 të LPP-së, i cili përcakton se:
"Autoritetet kontraktuese janë të obliguara të sigurojnë që fondet dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, duke marrë parasysh qëllimin dhe lëndën e prokurimit."

Në kundërshtim me parimet e LPP-së, AK ka shpërblyer me kontratë operatorin ekonomik (OE) – konkretisht kompaninë **LetaMed** – pavarësisht se oferta e tij ishte **më e lartë** sesa oferta jonë. AK ka eliminuar ofertën tonë **edhe pse kemi qenë plotësisht të përgjegjshëm dhe në përputhje me kushtet dhe kriteret e tenderit**.

Ky veprim i AK-së përbën **shkelje të dispozitave të LPP-së**, përkatësisht të neneve **1, 6, 7, 59 dhe 60**, duke mos garantuar trajtim të barabartë dhe duke diskriminuar kompaninë tonë në mënyrë të pajustifikueshme.
Në vijim do të paraqesim **të gjitha provat dhe argumentet për të dëshmuar se oferta jonë ishte plotësisht e përgjegjshme**, ndërsa vendimi i Autoritetit Kontraktues për eliminimin tonë ishte **i pabazuar dhe në kundërshtim të qartë me dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik**. Gjithashtu, do të dëshmojmë se ***operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë nuk ka qenë në përputhje me Dosjen e Tenderit dhe kriteret e përcaktuara në njoftimin për kontratë.***

Neni 7 – Barazia në Trajtim / Jo-Diskriminimi- Pro Medical nuk është trajtuar në mënyrë të barabartë nga Autoriteti Kontraktues. Ne konsiderojmë se kemi qenë subjekt i diskriminimit, pasi oferta jonë, e cila ishte në përputhje me të gjitha kriteret e tenderit, është eliminuar pa arsye të bazuara ligjërisht. Kjo përbën shkelje të parimeve të trajtimit të barabartë dhe të mosdiskriminimit, të garantuara nga LPP.

Për më tepër, edhe pse LetaMed duhet të konsideruar si ofertues i **papërgjegjshëm**, **AK ka favorizuar këtë OE në mënyrë të padrejtë**, në dëm të kompanisë sonë, duke mos e trajtuar procesin në mënyrë objektive dhe të paanshme.

Në Vendimin për Refuzimin e Kërkesës për Rishqyrtim, Autoriteti Kontraktues ka dhënë këtë arsyetim lidhur me OE-në e rekomanduar, pavarësisht se ne kemi evidentuar që ky OE nuk i ka plotësuar kriteret e përcaktuara në DT, konkretisht citohet: "**AK ka të drejtë të pranojë variante të barasvlershme ose më të avancuara, nëse nuk cenohet funksionaliteti"**. Ky arsyetim është përdorur për të justifikuar ofertën e Operatorit Ekonomik të rekomanduar. Megjithatë, në rastin tonë, një trajtim i tillë nuk është marrë në konsideratë nga Autoriteti Kontraktues, gjë që dëshmon për një zbatim jo të njëtrajtshëm të kritereve dhe për aplikimin e standardeve të dyfishta, në favor të Operatorit Ekonomik të rekomanduar.

Edhe pse Operatorit Ekonomik të rekomanduar i mungon përmbushja e disa kritereve administrative të përcaktuara në mënyrë të qartë në Dosjen e Tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë — të cilat do të shtjellohen më poshtë dhe janë të mbështetura me prova konkrete dhe të detajuara — Autoriteti Kontraktues ka vazhduar me rekomandimin e tij, duke injoruar shkelje që, në kushte të trajtimit të barabartë të operatorëve ekonomikë, do të duhej të rezultonin me eliminimin e këtij operatori nga tenderi.

Neni 59 – Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve -Gjatë procesit të vlerësimit të ofertës sonë, AK nuk ka respektuar dispozitat e Nenit 59 të LPP-së, si dhe të Nenit 72.2.
Në vend që të kërkojë informacione shtesë apo sqarime, AK ka ndërmarrë një vlerësim të pasaktë dhe të njëanshëm, me qëllim të eliminimit të ofertës tonë.
Dëshirojmë të informojmë AK-në se **arsyetimi për eliminimin tonë është në kundërshtim të qartë me parimet bazë të LPP-së**.
Megjithatë, AK ka për obligim që të ketë parasysh nenet 1,6,7, 59 dhe 60 të LPP-së dhe të kërkonte sqarime shtesë për ofertën tonë, para se të merrte vendim për eliminimin.
Ne jemi eliminuar me arsytimin si:

ARSYETIM

Tenderi i juaj eshte refuzuar: Komisioni vleresues gjatë vleresimit te tenderit ne fjalë ka konstatuar se kerkesa 6 sipas DT ku kërkohet të prezantojë katalogun me paisje ndersa ne oferta e juaj në disa prej produktev nuk figuron Emri i prodhusit, mungojn specifikat për disa produkte si: llampa kirurgjike nuk përputhet me specifiken e kerkuar nga AK.
Pozicioni: 5, sipas DT Negatoskop nuk ka paraqitur katalog dhe specifika për këtë produkt.
Aparati i bioskopis i kërkuar nga AK sipas specifikimit teknik të detyrushëm nuk është në përputhje me katalogun e ofruar nga GROE, gjithashtu nuk përputhen me specifikimin teknik EKG 12 kanalshe e ofruar nga GROE.
Defribilatori i prezantuar nga GROE nuk përshtatet me defibrilatorin e paraqitur ne katalog.

Kundërshtim ndaj vendimit të Autoritetit Kontraktues për eliminimin e ofertës sonë.

1. Kërkesa 6 – Katalogjet me nënvizim të specifikave

Në **Kërkesën 6 të Dosjes së Tenderit** , ku është kërkuar dorëzimi i katalogëve me nënvizim të specifikave teknike, kompania jonë ka përfshirë **katalogë për të gjitha pajisjet e ofruara**. Për secilin produkt janë përzgjedhur **faqet përkatëse nga katalogët zyrtarë të prodhuesve**, ku janë shënuar dhe **specifikat teknike sipas kërkesat e Dosjes së Tenderit.**

Sa i përket arsytimit të AK se "**nuk figuron emri i prodhuesit**", theksojmë se **ky nuk ka qenë kriter i përcaktuar në DT**, dhe për më tepër, të gjitha pajisjet janë paraqitur **me model të saktë dhe të identifikueshëm.**

Kërkesa 6 në DT:

Kërkesa 6 - Katalogjet me nenvizim te specifikave	**Dëshmia 6 - Te ofrohen kata nenvizuar specifikat.**

Neni 56 i LPP pragrafi 3 "*Tenderuesi, gjatë procedurave të hapura, ose kandidati, gjatë procedurave të kufizuara dhe procedurave të negociuara, pas publikimit të njoftimit të kontratës, nuk do të diskualifikohet ose përjashtohen nga procedurat e tilla në baza të ndonjë kërkese ose kriteri që nuk është i cekur në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit"*

Pra, Autoriteti Kontraktues nuk mund të na eliminojë mbi bazën e një kriteri që nuk ka qenë i përcaktuar si i tillë në Dosjen e Tenderit, apo që nuk është kërkuar qartë në dokumentacionin teknik (si, për shembull, përmendja e domosdoshme e emrit të prodhuesit në katalog), përderisa një kërkesë e tillë nuk ka qenë pjesë e kushteve të tenderit.

Duke marrë parasysh që katalogët zyrtarë janë voluminozë dhe të mëdhenj në përmbajtje, **nuk kemi mundur të dorëzojmë të gjithë katalogët e plotë**, por kemi bërë një **përzgjedhje të faqeve specifike për secilën pajisje**, të cilat përmbajnë informacionet kryesore teknike, të nevojshme për vlerësimin nga AK dhe emri i prodhuesit **nuk është i detyrueshëm të shfaqet në çdo faqe të katalogjeve zyrtare**, sidomos duke pasur parasysh që në kohën moderne shumica e katalogjeve janë në format online dhe paraqiten me dizajne dhe struktura të ndryshme.

Nëse për ndonjë artikull ka pasur ndonjë paqartësi ose vështirësi në identifikim për shkak të formatit të dokumenteve (PDF, printime bardh e zi, renditje etj), kjo nuk e ndryshon faktin që të gjitha specifikimet e kërkuara janë përfshirë dhe janë në përputhje me DT.

2. Lampa Kirurgjikale

Lampa kirurgjikale e ofruar nga kompania jonë përmbush dhe tejkalon kërkesat teknike të paraqitura në DT. AK ka vendosur si referencë orientuese modelin **AM-500LED**, një model standard i prodhimit Kinez, me karakteristika bazike.

Lampa kirurgjikale e ofruar nga kompania jonë është **jo vetëm barasvlershme**, por edhe **më e avancuar teknikisht** sesa modeli i përmendur në DT (AM-500LED).

Ne kemi ofruar modelin **Pentaled 30 E Light**, nga **SIMEON Medical (Itali/Gjermani)**, i cili ofron cilësi shumë më të lartë, jetëgjatësi më të madhe, dhe teknologji më të avancuar, përfshirë:

- Sistemi optik i patentuar,
- Kontroll digjital me funksione si Endo Light,
- Intensitet dhe temperaturë drite të personalizueshme,
- Jetëgjatësi LED mbi 60,000 orë.
- Levizje me rrota dhe flexibile

AK ka kërkuar që llampa të jetë **e pajisur me 4 rrota universale dhe të jetë e lëvizshme**, ku ne kemi ofertuar konfrom kërkesave të AK sipas specifikimeve teknike të përcaktuara në Dosjen e Tenderit dhe akoma më i avancuar.

Megjithatë, operatori ekonomik i rekomanduar ka ofruar një **model kinez që montohet në tavan, i cili nuk ka rrota dhe nuk është lëvizshëm**, pra është **një model krejtësisht tjetër** nga ai i kërkuar nga AK.

Model i oferuar nga OE i rekomanduar është i destinuar për **salla operacioni**,me montim ne tavan ndërsa QKMF si shërbim primar nuk posedon salla të tilla, gjë që e bën llmpa e ofertuar nga OE i rekomanduar është **jo praktike dhe jo funksionale për destinacionin e saj**.

Për më tepër, ky model **nuk i përmbush specifikimet teknike të kërkuara nga AK**, dhe për këtë do të ofrojmë **prova konkrete me poshtë dhe të verifikueshme** që mbështesin këtë pretendim.

3. Negatoskopi – Pretendimi për mungesë katalogu nga AK (i pabazuar)
Negatoskopi është përfshirë në **pozicionin 5 të katalogut të dorëzuar**, konkretisht në **faqen 6 në katalgon e Pro Medical**. Pajisja është prezantuar në **katalogun zyrtar të prodhuesit** dhe letë e verifikueshme.

Pra ne faqen 6 ka qenë pasije e kërkuar siq shihet edhe më poshtë

DOUBLE NEGATOSCOPE

Prandaj, **pretendimi i Autoritetit Kontraktues në këtë pikë nuk qëndron**, pasi nuk paraqet një situatë faktike dhe reale lidhur me ofertën tonë. Nga rrethanat e paraqitura, **është e qartë se qëllimi ka qenë eliminimi i ofertës sonë dhe favorizimi i operatorit ekonomik të rekomanduar**, gjë që përbën shkelje të parimeve të barazisë dhe konkurrencës në prokurim.

4. Aparati i Bioskopis – Arsyetimi i dhënë është i pabazuar dhe në kundërshtim me gjendjen faktike dhe reale për këtë pozicion, duke mos reflektuar saktësisht kërkesat e përcaktuara në paramase dhe në Dosjen e Tenderit (DT). **Një vlerësim i tillë përbën** kontradiktë të qartë dhe anomali të padrejtë në raport me ofertën tonë**, duke krijuar një situatë të pabarabartë dhe të padrejtë gjatë procesit të vlerësimit,** për një paisje që fiktive që nuk ka në paramasë fare pra Aprati i **Bioskopis.**
Në paramasë nuk ka aparat bioskopik, ashtu siç pretendon AK. Siç do të shpjegohet më poshtë, ky është një arsyetim fiktiv, i pabazuar në fakte konkrete dhe nuk pasqyron gjendjen faktike dhe reale të pajisjeve të kërkuar dhe të listuar në paramasë.



Vlerësimi nga AK duket të jetë bërë në mënyrë **shabllone** pa shqyrtim të mirëfilltë teknik, gjë që ngre dyshime të bazuara për **tentativë të eliminimit të ofertës sonë dhe favorizimit të OE-së së rekomanduar**.

5. EKG 12-Kanalëshe – Supozuar mospërputhje me specifikimet
EKG-ja e ofruar nga kompania jonë plotëson të gjitha kërkesat teknike të përcaktuara në DT, përfshirë: 12 kanale, lidhje me kompjuter, ruajtje të të dhënave, analizë automatike, dhe softuer për menaxhimin e të dhënave.
Gjithashtu, theksojmë se në DT specifikimet ishin nje brand të caktuar, të paraqitura në formë dhe modeli, dhe nuk përbëjnë kërkesa detyruese. Modeli ynë i ofruar është **i barasvlershëm dhe më e avancuar**.

6. Defibrilatori – Supozuar mospërputhje me katalogun

Modeli i defibrilatorit të ofruar është në përputhje të plotë me katalogun e dorëzuar si dhe me specifikimet teknike të përcaktuara në DT. Nëse ekziston ndonjë mospërputhje e vogël vizuale apo grafike, ajo **nuk ndikon në përmbajtjen teknike apo funksionalitetin e pajisjes**. Për më tepër, pajisja e ofruar është **e barasvlershme ose teknologjikisht më e avancuar**, sipas interpretimeve dhe sqarimeve të dhëna nga NJK.

Vërehet një anomali serioze në mënyrën e trajtimit të kërkesave tona për rishqyrtim nga Autoriteti Kontraktues (AK), pasi refuzimet e tyre nuk adresojnë drejtpërdrejt pretendimet dhe arsyetimet tona ligjore të cilat janë në përputhje të plotë me Ligjin për Prokurimin Publik (LPP), siç janë theksuar më herët në përgjigjet tona zyrtare.

Në vend që të ofrojë një vlerësim të drejtë, objektiv dhe të paanshëm të argumenteve tona lidhur me eliminimin e padrejtë nga procedura, Autoriteti Kontraktues ka devijuar vëmendjen nga thelbi i ankesës sonë. Në përgjigjen e dhënë, AK ka ndryshuar kontekstin e çështjes dhe ka shmangur adresimin e drejtë të arsyeve të argumentuara dhe të mbështetura me prova që ne kemi paraqitur për eliminimin tonë. Në vend të trajtimit të këtyre elementeve thelbësore, AK është kufizuar në një përgjigje sipërfaqësore, duke pretenduar se ne kemi kontestuar vetëm disa pika që lidhen me ofertën e Operatorit Ekonomik të rekomanduar, siç janë llampa kirurgjikale dhe një çështje në lidhje me kërkesën 8 certifikatë, ndërkohë që thelbi i ankesës sonë ka qenë mosplotësimi i kritereve të qarta teknike dhe/ose administrative nga ana e OE-së së rekomanduar, të cilat janë pjesë përbërëse e Dosjes së Tenderit.

Kjo qasje jo vetëm që bie ndesh me parimet themelore të transparencës, barazisë dhe trajtimit të barabartë në procedurat e prokurimit publik, por përbën gjithashtu një precedent shqetësues sa i përket mënyrës së trajtimit të kërkesave për rishqyrtim. Një trajtim i tillë cenon seriozisht objektivitetin, paanshmërinë dhe integritetin e të gjithë procesit të prokurimit publik, duke ulur besueshmërinë në AK dhe trajtimin ndaj operatorëve ekonomikë dhe duke rrezikuar konkurrencën e ndershme

Krahasimi Vednim i AK dhe Kerkesa jonë per Rishqyrtim(shiko)

6) PRETENDIMET TEKNIKE TË PRO MEDICAL

1. **Katalogjet**: Mungesë nënvizimi të qartë dhe mungesë e emrit të produktit për disa pajisje; **nuk qendron** pasi qe OE i rekomanduar ka plotesuar te gjitha kerkesa e AK sipas Aneksit 1 dhe kërkesës 6 të FTD.
2. **Lampa kirurgjikale**: OE i rekomanduar ka plotesuar kerkesen e AK sipas komisionit te vleresimit. Modeli i ofruar nga OE i rekomanduar është funksionalisht i përshtatshëm dhe i pajisur me certifikata përkatëse, **dhe pretendimet per kete pike nuk qendron.**
3. **Negatoskopi**: deshmit e ofrauara nga OE i rekomanduar jane te dëshmuar qartë se i përmbush të gjitha specifikat.
4. **Bioskop**: sipas komisionit te vleresimit OE i rekomanduar ka plotesuar kerkesen e AK ne përputhshmëri me parametrat thelbësorë të kërkuar.
5. **EKG 12-kanalëshe**: Te gjitha deshmit jane te ofruar nga OE i rekomanduar sipas komisionit te vlersues i cili eshte ne perputhsmeri me DT.
6. **Defibrilatori**: i odruar nga OE i rekomanduar eshte ne perputhje me te plote me kerkesat e AK te cilat jane ne përputhje të plotë teknike.

Arsytimi shtesë i përgjithshëm:

Disa nga pajisjet e ofruara nga kompania jonë janë **më të avancuara sesa specifikimet teknike të kërkuara nga AK**, ose janë të **barasvlershme dhe më të** **<u>më të avancuar</u>** **siq ka thënë AK sqarime me dt 16.04.2025**, por në çdo rast **plotësojnë plotësisht nevojat e NJK-së**, siç është konfirmuar edhe në sqarimet paraprake të AK-së dhe në DT citim ***<u>Vërejtje: Ne raste se ne specifikimet teknike ka ndonje fjale qe i referohet ndonje prodhimi apo ndonje brendi atëher vlen fjala barasvlefshme/ekuivalente.</u>***

Pavarësisht kësaj, vërehet një qëllim i qartë i AK për të eliminuar ofertën tonë në mënyrë të pajustifikuar dhe për të **favorizuar OE-në e rekomanduar**, duke na **mohuar të drejtën që përfitojm kontrata nga instucione publike dhe** në **kundërshtim të plotë me frymën dhe e LPP-së**, dhe bie ndesh me standardet e barazisë dhe konkurrencës së ndershme.

Neni 60 Kriteret për Dhënien e Kontratës- Gjatë këti aktiviteti të prokurimit AK nuk e ka respektuar Neni 60 Paragrafi 1 dhe alinenë 1.1 Sepse kriter për dhënie të kontratës publike ka qenë alineja 1.1 e paragrafit 1 pra alineja 1.1 citim "***tenderin e përgjegjshëm me çmimin më të ulët***" ne si OE i eliminuar kemi plotësuar kriteret në dosjen e tenderit dhe rrjedhimisht oferta e jonë ka qenë e përngjeshmë dhe me favorshme ne aspektin financiare.

Pretendimet kundër operatorit ekonomik të rekomanduar për kontratë
Ne kemi vërejtur se operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë **nuk i ka përmbushur disa nga kriteret administrative dhe teknike të përcaktuara në Dosjen e Tenderit (DT)**. Për më tepër, **ka devijime të qarta në disa pozicione lidhur me pajisjet e ofruara**, megjithatë është rekomanduar për kontratë.

Këto veprime janë në **kundërshtim me nenin 7 të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP)** dhe **nxisin dyshime të arsyeshme për favorizim të këtij operatori**, edhe pse **nuk i ka përmbushur plotësisht kriteret e DT-së**. Po ashtu, Autoriteti Kontraktues **nuk ka kryer një vlerësim të drejtë dhe në përputhje me nenin 59 të LPP-së**.

Pretendimi tona **kundër operatorit ekonomik të rekomanduar për kontratë**
Pretendim 1
Ne DT tek 9.1 & 9.2 pra Kapaciteti teknik dhe professional ka qene e cekur si:
Kërkesa 8 - Te kete servisim te rregullt nga serviser te trajnuar per aparaturen e ofruar.

Operatori ekonomik i rekomanduar nuk ka dorëzuar asnjë certifikatë që dëshmon se ka staf të trajnuar për pajisjet e ofruara në fushën përkatëse, dhe nuk ka paraqitur asnjë projekt apo aktivitet të mëparshëm të prokurimit që vërteton se posedon staf të trajnuar për këto pajisje.

Kjo tregon qartë se **operatori ekonomik i rekomanduar nuk e ka përmbushur kërkesën specifike të pikës 8 të Dosjes së Tenderit (DT)**, e cila ka të bëjë me **dëshmimin e kapaciteteve profesionale për mirëmbajtjen dhe përdorimin e pajisjeve mjekësore**.

Ky operator ka dorëzuar **vetëm një certifikatë për pajisjen laboratorike**, por jo eshe për **paisjet tjera siq ka kërkuar Ak në DT , pra OE i rekokoamduar ka dorzuar cerfikaten e** cila gjendet në **file nr. 11**, dhe stafi i trajnuar i përmendur në atë dokument **është i kompanisë tjetër – BioLab**. Kjo nënkupton që **operatori i rekomanduar nuk ka paraqitur asnjë certifikatë që dëshmon se ka staf të trajnuar për pajisjet mjekësore pra për** pajisjet e tjera që përfshihen në këtë aktivitet prokurimi të kërkuara në këtë tender, siç përcaktohet qartë në DT, dhe për rrjedhojë **nuk e përmbush këtë kriter thelbësor**.



Pretendim 2.

Lidhur me pajisjen "Aparati Biokimik", në Dosjen e Tenderit (DT) janë përcaktuar qartë edhe këto dy kërkesa specifike:

2. Pjesët rezervë – (të specifikohen pjesët shpenzuese):

Operatori ekonomik i rekomanduar **nuk ka dorëzuar asnjë listë të pjesëve rezervë apo shpenzuese (**pra rastin konkret për reagencave**)** për këtë pajisje, siç kërkohet në pikën 2 të specifikimeve teknike. Kjo do të thotë që ai **nuk ka përmbushur këtë kërkesë të detyrueshme të Aneksit 1 – Specifikimet Teknike të Detyrueshme**.

3. Posedimi i printerit laserik:

Po ashtu, për këtë pikë, **operatori nuk ka paraqitur asnjë deklaratë apo dokumentacion që vërteton se pajisja posedon printer laserik**, apo që ofron printer të tillë në ofertën e tij. Kjo është një tjetër **mospërputhje me Aneksin 1 – Specifikimet Teknike të Detyrueshme**, dhe përbën mungesë përmbushjeje të kritereve esenciale të DT-së.

Prodhues BE.

1. Servisi i autorizuar (Autorizimit)
2. Pjeset rezerv (te ceken pjeset shpenzuese)
3. Posedimi i Printerit Laserik
4. Trajnimi i stafit
5. Autorizim nga kompania ose distributor i autorizuar

Pretendim 3.

1. **Llampë Kirurgjikale me LED-** Në **Aneksin 1 – Specifikimet Teknike të Detyrueshme**, është specifikuar qartë se pajisja duhet të jetë "**e pajisur me 4 rrota universale**", pra një model i lëvizshëm dhe praktik për ambiente që nuk kanë struktura fikse të sallave të operacionit (shih foto bashkëngjitur si referencë për kërkesën nga AK-së).

Megjithatë, **operatori ekonomik i rekomanduar ka ofertuar një model që montohet në tavan,** i cili **është në kundërshtim të qartë me kërkesën e përcaktuar në DT** dhe **nuk përmbush funksionalitetin e kërkuar nga AK**, duke qenë i papërshtatshëm për institucionin përkatës që nuk disponon salla operative (shih foto e modelit të ofertuar).

Është e qartë se ekzistojnë ndryshime të mëdha në modelin dhe qëllimin e përdorimit të llampës së ofertuar nga OE i rekomanduar, në krahasim me kërkesën e përcaktuar nga AK. Pavarësisht këtij mospërputhjeje të theksuar, AK dhe NJK kanë vazhduar të favorizojnë këtë OE, duke e rekomanduar për kontratë, edhe pse pajisja e ofruar nuk përmbush kushtet e kërkuara në dokumentet e tenderit.
Model i oferuar nga OE i rekomanduar është i destinuar për **salla operacioni**, ndërsa QKMF nuk posedon salla të tilla, gjë që e bën llmpa e ofertuar nga OE i rekomanduar është **jo praktike dhe jo funksionale për destinacionin e saj**.

Ky veprim bie ndesh drejtpërdrejt me nenin 7 (Barazia në trajtim) dhe nenin 59 (Vlerësimi i ofertave) të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP), duke dëshmuar një qasje diskriminuese ndaj ofertës sonë dhe një vlerësim jo-konform me dispozitat ligjore në fuqi.
Për më tepër, ky model **nuk i përmbush specifikimet teknike të kërkuara nga AK**, dhe për këtë do të ofrojmë **prova konkrete me poshtë dhe të verifikueshme** që mbështesin këtë pretendim.
Citim nga DT



Ka edhe pozicione të tjera ku ekzistojnë dallime midis specifikimeve të kërkuara në DT dhe pajisjeve të ofruara nga OE i rekomanduar, si p.sh. **Defibrilatori, Respiratori**, etj. Këto devijime janë konsideruar të pranueshme për OE-në e rekomanduar nga AK, ndërsa për ofertën tonë janë refuzuar disa pozicione, **edhe pse pajisjet tona ishin më të avancuara dhe me cilësi më të lartë**.

Autoriteti Kontraktues është arsyetuar në vendimin e tij në lidhje me ofertën e Operatorit Ekonomik të rekomanduar, duke deklaruar se "***AK ka të drejtë të pranojë variante të barasvlershme ose më të avancuara, nëse nuk cenohet funksionaliteti".*** Megjithatë, një qasje e tillë bie ndesh me dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik, pasi lejon interpretim të njëanshëm dhe të paargumentuar të kritereve teknike, duke rezultuar në trajtim të pabarabartë dhe të pajustifikuar ndaj operatorëve ekonomikë. Kjo përbën shkelje të drejtpërdrejtë të parimeve të barazisë, transparencës dhe konkurrencës së ndershme të përcaktuara në nenet përkatëse të LPP-së.

Nëse një veprim dhe arsyetim i tillë nga ana e Autoritetit Kontraktues do të konsiderohej i pranueshëm, kjo do të krijonte një precedent të rrezikshëm që do t'i lejonte AK-së të rekomandojë fitues sipas diskrecionit të vet, duke anashkaluar kriteret e përcaktuara qartë në Dosjen e Tenderit dhe duke shpërfillur parimet themelore të Ligjit për Prokurimin Publik, siç janë transparenca, trajtimi i barabartë dhe konkurrenca e ndershme. Një praktikë e tillë jo vetëm që minon besimin e operatorëve ekonomikë në sistemin e prokurimit publik, por edhe e cenon rëndë integritetin e vetë procesit të prokurimit

Për këto arsye, kërkojmë nga Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) që të ndërhyjë për të parandaluar një veprim të tillë nga ana e Autoritetit Kontraktues, i cili bie ndesh me dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik dhe cenon në mënyrë të drejtpërdrejtë parimin e trajtimit të barabartë të operatorëve ekonomikë. Lejimi i një praktike të tillë do të përbënte jo vetëm shkelje të parimeve ligjore që rregullojnë prokurimin publik, por edhe rrezikim të transparencës dhe konkurrencës së ndershme në të gjitha procedurat e ardhshme të prokurimit.

Megjithatë, ne besojmë se AK duhet të marrë parasysh **sqarimet e dhëna përkatës**, dhe të pranojë pajisjet me devijime të vogla që **plotësojnë nevojat e NJK-së**, ashtu siç ka vepruar me OE-në e rekomanduar të veproj edhe per ne.
Në rastin konkret të llampës kirurgjikale të ofruar nga Operatorit Ekonomik i rekomanduar, vërehet një mospërputhje thelbësore me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit nga Autoriteti Kontraktues. Dokumentacioni i tenderit specifikon qartë se llampa kirurgjikale duhet të jetë me rrota (mobile), që siguron fleksibilitet dhe lëvizshmëri në ambientin kirurgjikal.
Megjithatë, OE i rekomanduar ka ofertuar një llampë statike të montuar në tavan, e cila jo vetëm që bie në kundërshtim me specifikimin teknik të kërkuar, por gjithashtu nuk përmbush funksionin praktik dhe operativ që kërkohet në kushte të punës reale në institucionet shëndetësore.
Ky ndryshim nuk është vetëm formal, por përbën një devijim thelbësor nga kërkesa teknike, dhe në përputhje me nenet përkatëse të LPP-së, do të duhej të rezultonte me moskualifikimin e ofertës së tillë, për shkak të mosplotësimit të kritereve të domosdoshme teknike.

Megjithatë, ky devijim është pranuar për OE-në e rekomanduar, ndërsa për ofertën tonë, **devijimet minimale nuk janë pranuar**, pavarësisht që pajisjet tona plotësojnë qëllimin dhe nevojat e NJK-së.

Ky veprim tregon qartë **zbatimin e standardeve të dyfishta nga ana e AK-së në procesin e vlerësimit**, në kundërshtim me **parimet e barazisë, transparencës dhe konkurrencës së ndershme të përcaktuara në Ligjin për Prokurimin Publik (LPP).**

VENDIMI

Aprovohet Ankesën për Rishqyrtim si e bazuar e OE " Pro Medical"
Dhe lenda të Ri-kethen ne ri-vlersim.

Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar ka shkaktuar ose kërcënohet t'iu shkaktojë dëme materiale, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Shkeljet e AK, përkatësisht **eliminimi i ofertës sonë në mënyrë të pajustifikuar dhe në kundërshtim me Ligjin për Prokurimin Publik**, na kanë shkaktuar dëme materiale të konsiderueshme dhe të drejtpërdrejta.

Kompania jonë ka investuar kohë, burime financiare dhe njerëzore në përgatitjen e kësaj oferte, përfshirë përkthimin, përgatitjen e katalogëve të personalizuar, mbledhjen e certifikatave dhe dokumenteve të tjera teknike dhe administrative, si dhe sigurimin e ofertës financiare konkurruese dhe të përgjegjshme.

Për më tepër, **oferta jonë ka qenë dukshëm më e ulët në çmim krahasuar me atë të OE-së së rekomanduar**, prandaj **do të kishim përfituar kontratën nëse do të ishim trajtuar në mënyrë të barabartë dhe në përputhje me LPP**. Eliminimi ynë i padrejtë na ka privuar nga një kontratë publike me vlerë të konsiderueshme, e cila do të kishte ndikuar drejtpërdrejt në të ardhurat dhe zhvillimin e mëtejshëm të kompanisë sonë.

9. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

a) *Te gjitha dokumentet relevante jane ne e-prokurimi*